Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

**NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR KURBIN**

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

Vula



**NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR KURBIN**

**Shtojca 7**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilesinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organizatës administrative, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP<sup>1</sup>.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorit ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Nënshkrimi i ofertuesit** \_\_\_\_\_

**Vula** \_\_\_\_\_

<sup>1</sup> Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

**Shtojca 7/1**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik* ]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE  
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## **Shtojca 8**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

1. Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Në rast se ka dyshime mbi vërtetësinë e këtij deklarimi, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme.**

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;*

b. *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1*

c. *Sigurimi i ofertes, (nëse është zbatueshëm) sipas Shtojcës 3;*

ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*

e. *Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 7/1;*

dh. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ofertues duhet të paraqesë Licencë QKL për ushtrim aktiviteti “Sigurimi Fizik i Personave dhe Objekteve Shtetërore e Private”, me roje të kategorisë 1.3.A dhe Certifikatë profesionale të Titullarit të Subjektit të kategorisë 1.3.A, konform Ligjit nr. 75, datë 10.07.2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” bashkëlidhur dhe vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
2. Operatori ofertues duhet të paraqesë Certifikatë profesionale të Drejtuesit Teknik të kategorisë 1.3.A, konform Ligjit nr. 75, datë 10.07.2014, “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.
3. Operatori ofertues duhet të paraqesë katër Certifikata profesionale për ushtrim profesioni të rojes lëshuar nga DPQ Lezhë.

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ofertues duhet të paraqesë Vërtetim nga Administrata Tatimore mbi xhiron mesatare vjetore si dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit 2017-2018-2019. Xhiro vjetore duhet të jetë, në një vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit.
2. Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2018-2019-2020, për adresat ku ushtron aktivitet operatori ekonomik, sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKB.
3. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit Korrik-Gusht-Shtator (2020), shoqëruar me **listë pagesat e sigurimeve shoqërore** (formularët E-sig 025a) për këtë periudhë të konfirmuara me vule elektronike nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht **6 punonjës** të siguruar në muaj, **4 punonjës shërbimi roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.**

### 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ofertues duhet të paraqesë deshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit dhe fatura tatimore të realizuara gjatë aktivitetit të shoqërisë në tre vitet e fundit, me vlerë jo më të vogël se 39% të fondit të venë në dispozicion të shoqëruara me referenca për realizimin me korrektesë të kontratës së paraqitur.

**NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR KURBIN**

Kur sherbimi i ngjashem është realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetem fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.

2. Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave për radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me zonë mbulimi duhet të ketë zone mbulimi objektin për të cilin prokurohet.
3. Operatori ofertues duhet të paraqesë Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qytetin ku kerkohet sherbimi sipas Udhezimit Nr.130 dt. 05.03.2018 te Ministrit te Brendshem “Per Funkcionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike” ku ushtron aktivitetin SHPSF.
4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim/Performancë nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Lezhe të lëshuar mbas muajt gusht 2020, nëpërmjet të cilit të jepet informacioni mbi: të paktën kater punonjës të licencuar nga DPQ; Të ketë nje armë brezi, të ketë përgjegjës shërbimesh, të mos ketë marre masë administrative për (operatorin ekonomik, Titullar dhe drejtues Teknik) nga per vitin 2018-2019-2020. Të ketë pesë operatore në sallën operative dhe grup të gatshëm 6 punonjes sherbimi (3 turne X 2 punonjes per turn). Ky vërtetim duhet të përmbajë informacionin dhe opinionin pozitiv për operatorin ekonomik.
5. Ofertuesi duhet të disponojë se paku nje automjet për ndërhyrje në raste emergjente, shoqëruar dhe me leje drejtimi të drejtuesit të mjetit, në pronësi të shoqërisë apo të marrë me qera. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Leje e Qarkullimit dhe taksat e automjetit (të vlefshme) në pronësi të shoqërisë.

Në rastin kur automjeti është marre me qera, Leja e Qarkullimit duhet të shoqërohet edhe me Kontratën noteriale të marrjes me qera, ku të jetë përcaktuar afati dhe qëllimi i marrjes me qera.

6. Per sistemin e Alarmit.  
Lidhur me sistemin e alarmit ne oferte te specifikohet me TVSH apo pa TVSH.  
Sherbimi i monitorimit te sistemit te alarmit te kryhet nga operatoret permes salles operative.  
Ruajtja e objektit me sistem alarmi do te behet 24 ore ne dite.  
Operatori ekonomik për këtë pikë duhet të disponojë 1 (një) punonjës specialist i kualifikuar, i diplomuar në profil elektronik/ informatik/ informaticien/ Teknologji Informacioni/ kompjuterik ose ekuivalent, dhe i çertifikuar për sistemet e alarmit, për të cilët operatori ekonomik duhet të paraqesi certifikate trajnimi nga kompani te licencuara. OE për punonjësin e mësipërm duhet të paraqesë diplomën dhe çertifikatën përkatëse, si dhe të figurojë në listëpagesat e subjektit për periudhën tre muajt e fundit.
7. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizën e kostos për ofertën e paraqitur. (**Shih Shtojca 1 - Sqarime**) duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore.  
**Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit si (paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shëndetësore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të s’kualifikohen.**

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s’kualifikim.

## **Shtojca 9**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Skicimet, paprametrat teknik etj:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Kontrata do te lidhet **per 3.32 punonjes per nje periudhe 12 Mujore nga moment I nenshkrimit te Kontrates.**

Vlera e ofertes duhet te paraqitet ne lek/me muaj per punonjes sherbimi

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Objektet e NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR KURBIN qe kerkohen te ruhen nga (SH.P.S.F) jane objekti I godines se NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR KURBIN dhe Godina e Higjenes dhe Epidemiologjise me sherbim alarmi 24 ore

**16 ore Turni I Dyte dhe Turni I Trete per 12 muaj .**

2. Te mbuloje te gjitha shpenzimet si paga te rojeve, sigurimet shoqerore te personelit te punesuar nga ana e tij per ruajtjen e objekteve, shpenzimet per uniformat, armatime, nderlidhje si dhe gjithë kompensimet e tjera te njohura me ligj.

3. Sigurimi i rendit dhe qetesise ne objektin qe ruan, duke parandaluar demtimin e prones se punedhensesit ose vjedhjen e saj.

4. Te ushtroje kontroll te here pas hershem te personave qe hyjne ne teritorin e objektit qe ruhen si dhe automjeteve qe qarkullojne ne teritorin e saj.

5. Te kerkoje zbatimin e rregullave te percaktuara nga punedhensesi si dhe rregulloreve te brendshme te nxjera nga ky i fundit te cilat do te jene pjese perberese e kesaj kontrate.

6. Te informoje regullisht titullarin e institucionit per shkelje te konstatuara.

7. Gjate sherbimit punonjesi do te jete me uniformen e caktuar dhe me karten e identitetit personal per cdo punonjes.

8. Cdo vendroje do te jete i pajisur me armatimin e domosdoshem dhe me pajisjet ndihmese qe percaktohen ne ligjet dhe udhezimet perkatese.

9. Pervec specifikimeve te mesiperme, marredheniet me te detajuara midis SH.P.S.F dhe Drejtorise se NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR KURBIN do te jepen ne rregulloren e sherbimit qe do te jete pjese perberese e kontrates si dhe zbatimin e Ligjit nr **75/2014** date 10.07.2014”Per sherbimin privat te Sigurise “.

Dokumentat Standarde të Tenderit

---

**NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR KURBIN**

**Shtojca 10**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>		
<b>02</b>		
<b>03</b>		
<b>...</b>		

**Shtojca 11***(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)***SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet: Objekti: “Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Kurbin Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike 3.32 Roje dhe Alarm” – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj.**

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj ( i parashikuar)

**Vendndodhja e shërbimit: Lagjia nr 4 Laç-Kurbin**

Numri i Vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve te nevojshme	Afati i levrimit
<b>1</b>	(T2+T3) për ditët e punës, ditët e pushimit dhe ditët e festave zyrtare	<b>3.32</b>	<b>12 muaj</b> <i>Kontratat do të jepen nga momenti i lidhjes së Marrëveshjes Kuadër me OE shpallur fitues nga kjo procedurë prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat përfundimtar 12 muaj.</i>
<b>1</b>	(T1+T2+T3) për ditët e punës, ditët e pushimit dhe ditët e festave zyrtare	Ruajtje me sistem alarmi Godina e Higjenes dhe Epidemiologjise me shërbim alarmi 24 ore	<b>12 muaj</b> <i>Kontratat do të jepen nga momenti i lidhjes së Marrëveshjes Kuadër me OE shpallur fitues nga kjo procedurë prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat përfundimtar 12 muaj.</i>



## Shtojca 12

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### **TERMAT E REFERENCËS**

1. Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

**“Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Kurbin Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike 3.32 Roje dhe Alarm” – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj.**

Kontratat do të lidhen sipas afateve të përcaktuara nga AK.

2. Objektivat:

- Të ruajë objektin në zbatim të Rregullores së Brendshme të institucionit.
- Të ruajë rendin dhe të sigurojë jetën e personelit.

3. Detyrat e kontraktorit:

Kontraktori ka për detyrë:

- Të hartojë Rregulloren e Shërbimit dhe t’ja paraqesë Autoritetit Kontraktor.
- Të hartojë grafikun e shërbimit duke siguruar shërbimin e vazhdueshëm në të gjitha ditët e javës me turne dhe t’ja paraqesë çdo muaj Autoritetit Kontraktor duke përcaktuar emrat e punonjësve të shërbimit për çdo ditë dhe për çdo turn.
- Të ndërhyjë me grupin e gatshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi, në çdo rast që paraqitet nevoja dhe të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast të cënimit të institucionit ose të personelit.

Punonjësi i shërbimit ka për detyrë:

- Të zbatojë Rregulloren e Shërbimit të hartuar nga Drejtuesi Teknik
- Të zbatojë Rregulloren e Brendshme të institucionit
- Të zbatojë grafikun për shërbimin me rojet private duke u paraqitur 10 minuta përpara dorëzimit të turnit.
- Të sigurojë ruajtjen dhe rendin në këtë objekt.
- Të mos lejojë futjen e personave në objekt pa flete-hyrje.
- Të mos lejojë hyrjen dhe daljen e materialeve pa dokumentin përkatës.
- Të sigurojë parkimin e automjeteve të A.K sipas vendeve të përcaktuara nga institucioni.
- Të kontrollojë masat e sigurisë së objekteve si rrethimin, ndriçimin, gadishmërinë e sistemit të ndërlidhjes, mbrojtjes ndaj zjarrit dhe për çdo parregullsi të informojë duke vënë në dijeni përgjegjës të tij dhe ky i fundit njofton personin e autorizuar të Autoritetit Kontraktor për çdo mangësi të konstatuar.
- Para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzuese dhe për çregullimet e konstatuara njofton përgjegjës të rojeve dhe përgjegjës të shërbimeve të brendshme të institucionit, duke bërë shënime përkatëse në librin e shërbimit.
- Të njohë dhe zbatojë rregulloren për mbrojtjen kundra zjarrit. Në rast zjarri të marrë masa për shuarjen e tij dhe menjëherë njofton zjarrfikset, përgjegjës të rojeve dhe përgjegjës të shërbimeve të brendshme të institucionit.
- Kur në objekt kryhen vepra penale, roja bën bllokimin e mjedisit dhe të autorit dhe njofton menjëherë organet kompetente

**NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR KURBIN**

- Të jetë i paisur me armë dhe ta përdorë atë në bazë të legjislacionit në fuqi.
- Të karakterizohet nga sjellja qytetare në komunikim me personat.
- Ndalohet futja dhe qëndrimi i rojës në ambientet e brendëshme të objektit përjashtuar rastet për zbatimin e rregullores.
- Rojes, gjatë kohës së shërbimit i ndalohet të pijë pije alkolike, të flejë, të bisedojë me persona të jashtëm.
- Të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast të cënimit të institucionit ose të personelit.

4.Vendi i kryerjes së shërbimeve: **NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR  
KURBIN  
SHERBIMI I HIGJENES DHE EPIDEMIOLOGJISE**

**Shtojca 13**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>2</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

**Shtojca 14**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Dokumentat Standarde të Tenderit

---

**NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR KURBIN**

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

## **Shtojca 15**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Dokumentat Standarde të Tenderit  
**NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR KURBIN**

---

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

Dokumentat Standarde të Tenderit

---

**NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR KURBIN**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 16.**

**KUSHTET E PËRGJITHSHME**  
**Shërbimet –Kërkesë për propozim**

**Neni 1: Qellimi**

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.

---

**NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR KURBIN**

- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontratore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

**Neni 3: Hartimi i Kontratës**



---

**NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR KURBIN**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të sherbeje per hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 4 Praktikrat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 5 Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6 Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.

---

**NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR KURBIN**

- 6.4** Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

**Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

- 7.1** Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
- 7.2** Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 7.3** Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.4** Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

**Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit**

- 8.1** Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.
- 8.2** Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 8.3** Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

**Neni 9 Specifikime dhe Skicime**

- 9.1** Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatisi të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuar dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marri parasysh standartet më të fundit.
- 9.2** Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë pregatitur në bazë asnjënjësore përpara i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

**Neni 10 Lejet dhe Liçensat**

---

**NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR KURBIN**

**10.1** Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

**Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**

11.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Kontraktuesit.

11.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.

11.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.

